



**VENDIM**

**Nr. 141 Datë 07.12.2011**

**PËR**  
**SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË HEC LANABREGAS**  
**SH.A PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Hec Lanabregas sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin Planit të Investimeve të Hec Lanabregas sh.a, për vitin 2012,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë Hec Lanabregas sh.a, për Planin e Investimeve për vitin 2012 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

**Vendosi:**

1. Të miratojë aplikimin e Hec Lanabregas sh.a për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2012.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e Hec Lanabregas sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**